

Raporti Vjetor 2015



Rreth FIQ

Forumi për Iniciativa Qytetare - FIQ është fondacion kombëtar me një traditë të gjatë të punës me qytetarët. Informimi, edukimi dhe mobilizimi i qytetarëve për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie prej institucioneve vendim marrëse, përbëjnë thelbin e punës së FIQ-it.

Nxjtja dhe përkrahja e koncepteve të ndërrmarrësisë, ideve inovative, takimeve dhe diskutimeve me komunitetin janë disa prej aspekteve metodologjike të punës, të cilat formësojnë profilin e organizatës tonë duke e identifikuar FIQ-in si një fondacion tipik komunitar.

E kur flasim për vizionin e FIQ, përderisa qytetarët të bëhen faktor në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, **vizioni jonë** do të jetë pikërisht “*mobilizimi i qytetarëve për tu angazhuar në proceset zhvillimore nëpërmjet aktivizmit qytetarë, ndërrmarrësisë dhe përfshirjes së drejtpërdrejt në vendim marrje.*”



Stafi i FIQ



Dajana Berisha

Drejtoreshe Ekzekutive

TË DASHUR MIQ!

Sa herë që ulem të shkruaj për punën e FIQ-it për vitin që lamë pas, një grumbull ndjenjash, mendimesh luajnë me fjalët duke ma kontekstualizuar mesazhin në tri përjetime të cilat më së shumti reflektojnë sfidat e punës së FIQ-it në realitetin politik, ekonomik, social të Kosovës.

Me **krenari** vërej, se FIQ po shndërrohet në një fondacion kombëtar, që me përkushtim, efikasitet dhe aftësi adaptuese po udhëheq në sektorin civil në Kosovë në proceset e vetëdijësimit dhe mobilizimit të qytetarëve për të kërkuar transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje në vendim-marrjet publike.

Iniciativat e realizuara gjatë 2015 veç ma përforcojnë këtë deklaratë, andaj ju ftoj, të lexoni më poshtë sukseset e punë sonë e të kuptoni, krenarinë tonë!

Sigurisht, që në të përditshmen tonë ka dhe momente **trishtimi, dëshpërimi** teksa përpiqemi, të sfidojmë një realitet politik në të cilin qytetari lihet jashtë çdo planifikimi, jashtë çdo të drejtë për të vendosur për të ardhmen e vet dhe të gjeneratave të ardhshme, në një realitet ekonomik në të cilin të rinjtë përbëjnë rreth 70% të të papunëve të Kosovës dhe në një realitet arsimor i cili ndodhet në udhëkryq.

Mirëpo, këto momente dëshpërimi shndërrohen në **energji dhe shpresë** e cila na udhëheq përgjatë gjithë vitit dhe punës sonë në terren. Në vizionin e punës së FIQ-it, *qytetari dhe cilësia e pjesëmarrjes* në procese vendim-marrëse, zënë vendin themelor.

Eshtë pikërisht ky vision që na bën të përkushtohemi dhe më tej ndaj 33 mijë nëshkruesve të Peticionit të cilët kundërshtojnë rritjen e çmimit të energjisë elektrike, mungesës së transparences së ZRRE-së, arrogances së pushtetit i cili thellon varfërinë dhe rrit varësinë e qytetarëve prej politikanëve të korruptuar.

Në të gjitha takimet e mia me komunitetin, në çdo lagje, fshatra apo qytete me qytetarë të moshave të ndryshme, ajo çka e ripërtërin energjinë positive tek unë dhe kolegët e mi, është pikërisht shpresa, që qytetarët kanë tek FIQ. **Eshtë besimi, që ata kanë për ti udhëhequr në ndryshimin e të përditshmes së tyre, që i jep FIQ-it dimensionin e duhur, atë të faktorit që mund të sjell ndryshime!**

Miqësisht,
Dajana Berisha



Puna me komunitetin

Vizion, përkushtim, pasion, mobilizim

Kuvendi i Republikës së Kosovës
gjymton vullnetin dhe të drejtat e
33 mijë qytetarëve!

Në fund të vitit 2014, FIQ në kuadër
të Konsorciumit të Organizatave
të Shoqërisë Civile për Zhvillim të
Qëndrueshëm KOSID, organizoi
peticionin për mbledhjen e
nënshkrimeve nga qytetarët në
shumicën e komunave të Kosovës.
Peticioni u realizua për të shprehur
pakënaqësinë dhe kundërshtimin
qytetar ndaj shtrenjtimit të çmimit
të energjisë elektrike, mungesës së
transparencës së plotë nga ana e
ZRRE-së.

33 mijë nënshkrime në 4 ditë!

Saga e Peticionit!

Në Janar 2015 peticioni me mbi 33.000
nënshkrimet u dërgua në Parlament,
mirëpo, dokumenti asnjëherë nuk ju
paraqit deputetëve si një paketë me
kërkesat specifike të qytetarëve për të
votuar, por mbi të u bënë ndryshime
prej komisioneve të ndryshme
parlamentare, duke gjymtuar kështu
kërkesat e qytetarëve.



FIQ do të vazhdojë të sfidojë Kuvendin e Kosovës për ta risjellë petitionin në vëmendjen e deputetëve dhe për ta shqyrtuar atë si një paketë të nënshkruar prej 33 mijë qytetarëve.



Kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës që:

- 1) Të rekomandojë që Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE të anulojë Vendimin V.645.2014 e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë të datës 29 gusht 2014, sidomos duke njohur faktin që rrethanat e jashtëzakonshme (me rastin e shpërthimit në Kosovën A) që u përdoren si arsytim për rritjen e çmimit të energjisë kanë kaluar;
- 2) Të kërkon shkarkimin e anëtarëve të Bordit të ZRRE-se, duke rikujtuar dështimin e këtyre të fundit që të mbrojnë interesin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, si dhe të ketë parasysh:
 - a. Mos marrjen për bazë të gjendjes sociale dhe ekonomike të konsumatorëve me rastin e vendosjes së tarifave të reja, ashtu siç kërkohet me nenin 1 të Ligjit për ZRRE;
 - b. Ndikimin politik të anëtarëve të Bordit, me ç'rast Bordi i ZRRE nuk ka marrë vendim për tarifën e energjisë para datës 31 mars 2014, atëherë kur kanë skaduar tarifën e energjisë, por duke marrë vendim menjëherë pas zgjedhjeve nacionale të 8 qershorit 2014;
- 3) Të obligoj Qeverinë që të sjell në Kuvend propozimet për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ku do të largohej TVSh prej 16% nga fatura e energjisë elektrike;
- 4) Të anulojë vendimin e Kuvendit të Kosovës dhe të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për rentën prej 3 euro për ton qymyri të shfrytëzuar;
- 5) Të obligoj Qeverinë që të sjell në Kuvend propozimet për ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-185 për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, sipas së cilit do të obligohet ZRRE të ndryshoj rregullat për vendosjen e çmimeve. Po ashtu, përmes këtij Ligjit të ri për ZRRE, Kuvendi duhet të obligojë Bordin e ZRRE që përveç ndryshimit të rregullore për vendosjen e çmimeve, të aprovoj një rregullore për mënyrën e përllogaritjes së gjendjes sociale dhe ekonomike të konsumatorëve të energjisë, ashtu siç kërkohet me nenin 1, pika 4, të Ligjit aktual për ZRRE.

Duke njohur faktin që, ky petition përmbledh vullnetin e 33,000 qytetarëve të Kosovës, si nënshkrues të kësaj nisme legjislativë qytetarë, ushtrijnë të drejtën e tyre konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 79) dhe kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës ndryshimet e nevojshme ligjore (Ligji nr. 04/L-025 për Nisma Legjislativë) që do të krijonin parakushtet që çmimi i energjisë elektrike të reflektoj gjendjen sociale dhe ekonomike të konsumatorëve të energjisë elektrike."

“Dhuro pemën tënde – Jepi jetë një komuniteti”

Qytetarët me ajrin më të ndotur në Europë, me një numër të madh të vdekjeve të parakohshme, me më së shumti të sëmurë më kancer në raport me numrin e popullsisë lokale, qytetarët e Hades, të harruar nga institucionet vendore, **ndihen të përkrahur veç prej FIQ!**

“Bashkepunimin me FIQ e kemi fillu disa vite më parë dhe pasi që na kanë lënë pas dore Komuna, KEK-u dhe Qeveria, FIQ-i ka qenë i vetmi që na ka dalë ndihmë dhe kemi pasë bashkepunim të shkelqyeshëm me FIQ-in.

FIQ-i është ai i cili ka ardhë i ka bërë presion Komunës, Qeverisë. FIQ-i na ka vizitu, na ka ardhë në protesta ka organizu takime e gjithçka. Falenderojme shumë organizatën FIQ dhe drejtoreshen Dajanen ku as Kryetari i Komunës nuk ka bërë asgjë drejtoresha e FIQ-it në këtë komunitet.”

Ragip Grajqevci, banor i fshatit Hade

Kampanja “Dhuro pemën tënde – Jepi jetë një komuniteti”u realizua me qëllim ngritjen e fondeve në kuadër të “Javës së Energjisë”, fonde të cilat u mbledhën për mbjelljen e luleve dhe drunjëve në fshatin Shkabaj.

FIQ-i arriti të mbledhë **mbi 2500 EUR**, me qëllim promovimin e një mjedisi të shëndetshëm për qytetarët e zhvendosur të Hades duke i vendosur ata në qendër dhe duke realizuar e nxjerrë në pah vlerat e qytetarisë aktive, solidaritetin e qytetarëve në mungesë të vizionit zhvillimor dhe të qëndrueshëm për këtë komunitet, që vuan pasojat e zhvendosjes së dhunshme për të hapë rrugë gërmimeve të Mijes për Termocentralin “Kosova e Re”.





Fondet e mbledhura gjatë kësaj kampanje ishin kontribute të qytetarëve, bizneseve vendore, organizatave të shoqërisë civile vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në Kosovë.



Mike Hudson, gazetar investigativ i International Consortium of Investigative Journalism duke biseduar me banorët e Hades së Vjetër rreth çështjes së zhvendosjes për ti.

Nën autorizimin e përfaqësuesve të Hades së Obiliqit, Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e FIQ-it, fton në vizitë Panelin e Inspektimit të Bankës Botërore, me qëllim investigimin e zhvendosjes së banorëve të fshatit Hade¹.

¹ [http://ewebapps.worldbank.org/apps/ip/PanelCases/103Inspection%20Panel%20Report%20%20and%20Recommendation\(shqiptar\).pdf](http://ewebapps.worldbank.org/apps/ip/PanelCases/103Inspection%20Panel%20Report%20%20and%20Recommendation(shqiptar).pdf)



Dajana Berisha, FIQ diskuton me Gonzalo Castro De La Mata, Shef i Panelit të Inspektimit të Bankës Botërore dhe e fton Panelin e Inspektimit të investigojë çështjen e Zhvendosjes së dhunshme të banorëve

të Hades prej 2004 duke e bërë atë një prej temave kryesore të konferencës ndërkombëtare “Multilateral Financial Institutions - What progress concerning Human Rights and Accountability?”

FIQ ndërkombëtarizon zhvendosjen e dhunshme të banorëve të Hadës

Banka Botërore ka luajtur një rol aktiv në formësimin e planeve energjetike të Kosovës që nga viti 2001. Ajo ka siguruar fonde dhe mbështetje teknike për zhvillimin e termocentralit të ri, për të zgjeruar minierën e linjitit, zhvendosjen e komuniteteve të prekura dhe ka monitoruar këtë proces.

Ankesa të shumta nga banorët vendas të lënë jashtë çdo vëmendje institucionale, nëpërmjet FIQ prezantojnë brengat e tyre në medium të ndryshme ndërkombëtare duke rezultuar në investigimin e këtij problem prej gazetarëve të ndryshëm ndërkombëtarë dhe më në fund prej Panelit të Inspektimit të vetë Bankës Botërore. Kjo e fundit, në bashkëpunim profesional me FIQ dërgoi në Kosovë

ekspertët e vet për analizimin e këtyre çështjeve në gushtin e vitit 2014 të cilët më pas rekomanduan një hetim të plotë të çështjes në Janar të 2015².

² F. Rekomandimi

73. Parashtruesit e kërkesës dhe kërkesa i përmbushin kriteret e pranueshmërisë teknike të parapara me Rezolutën për themelimin e Panelit Inspektues dhe Qartësim-it, të vitit 1999.

Gjithashtu, dhe duke u bazuar në vërtetimet e lartcekura, Paneli ka konstatuar se ekziston një lidhje e mundshme midis dëmit të pohuar në Kërkesë dhe projekteve, ashtu siç parashihet në Procedurat operative të Panelit.

74. Prandaj, Paneli rekomandon ndërmarrjen e një hetimi për çështjet e pretenduara të dëmeve dhe mospajtueshmërinë me politikat dhe procedurat operative të Bankës Botërore në raport me ndihmën teknike të financuar nga Banka dhe me aktivitetet e tjera, meqë ato ndërlidhen me kërkesën dhe me procesin e përgatitjes së PEK-së. Më konkretisht, hetimi do të shqyrtojë mospajtueshmërinë e mundshme të Bankës në lidhje me zhvendosjen e lagjes Shala të fshatit Hade dhe dëmet e pohuara në Zonën me interes të veçantë ekonomik, të pësura nga parashtruesit e kërkesës.





Paneli i Inspektimit përballë qytetarëve të Hades së Vjetër që presin të zhvendosen!

Paneli i Bankës për Inspektimin, një mekanizëm i pavarur brenda Bankës Botërore, vizitoi Kosovën në fund të Gusht të 2015 për të kryer hetimin e plotë rreth këtij operacioni. **Pritet që raporti i investigimit të Panelit të Inspektimit të bëhet publik në Shtator të 2016.** Ky raport do ti dërgohet

manaxhementit të Bankës Botërore, të gjithë Drejtorëve Ekzekutivë anëtarë të Bordit të Bankës Botërore dhe në fund Presidentit të Bankës Botërore të cilët do të vendosin për masat e nevojshme dhe detyrimet e qeverisë së Kosovës ndaj banorëve të fshatit Hade e vjetër dhe Shkabaj.



**Inovacion, ngritje
e kapaciteteve
dhe punësim
nëpërmjet
ndërmarrsisë së
të rinjve**



**FIQ hapë mbi 60 vende pune
në Bujqësi dhe Ekoturizëm;
trajnon dhe çertifikon rreth
100 të rinj!**

ATAR Programi Përsheptues në Bujqësi & Turizëm për të Rinjtë është një ndër ndërhyrjet më të suksesshme të Forumit për Iniciativa Qytetare (FIQ) në adresimin e problemeve të vetpunësimit të të rinjve në Kosovë. Në partneritet me Scards Academy dhe Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe me mbështetjen e Komisionit Evropian FIQ-i krijoi rreth 25 bizneseve të reja në fushën Bujqësisë dhe Ekoturizmit duke mundësuar kështu, trainimin e 50 të rinjve për ndërmarrësi dhe punësimin e rreth 70 të rinjve.


Nxitja dhe promovimi i ndërmarrësisë sociale nëpërmjet ideve të gjelbëra dhe innovative – FIQ inkurajon sektorin bankar për investime në ekonominë e gjelbërt



Gara “**Ide Biznesi - Të Gjelbërta dhe Inovative 2015**” - qasje innovative ndaj konceptit të ndërmarrësisë në Kosovë.

Gjatë vitit 2015 FIQ identifikoj dhe mbështeti 3 fituesit në nivel kombëtar të cilët vazhdojnë të njohin veç suksese në ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve të tyre:

- Havushe Bajrami-Bunjaku – “**99 Lule**” – Prodhimi i çajrave dhe bimëve aromatike dhe mjekuese nga gratë kryefamiljare që vijnë nga familje me asistencë sociale dhe që jetojnë në viset malore në fshatrat rreth Liqenit të Badovcit.



- Rron Ceka – “formon” – **Krijim inovativ i printerit 3D**, ku në vend të plastikës klasike të rrezikshme dhe të dëmshme për ambientin, përdorë si lëndë të parë plastikën biodegraduese e fituar nga përzierja e niseshtes së grurit dhe patates.
- Ymer Dullaj – “**EkoFerma**” - Krijimi i një modeli të suksesshëm për fermat në gjithë Kosovën me qëllim kursimin e energjisë elektrike, mbrojtjen e ambientit dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet përdorimit të biogazit që prodhohet nga mbetjet e pulave, si energji alternative.

Të tre fituesit kanë përfituar nga një start-up grant në vlerë prej 2,500€ nga Raiffeisen Bank në Kosovë, si partnerë të FIQ-it në kuadër të këtij projekti³.

³ <http://www.raiffeisen-kosovo.com/en/Press-Releases/Raiffeisen-Bank-supports-147Business-Ideas-Competition-150-Green-and-Innovative-2015-148-435>

Avokim

Filantropia për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë!

“Muaji i Filantropisë” tashmë është shndërruar në një traditë në Kosovë.

Konferenca “Kosova drejt Parisit COP21”

Platforma EKOSOVA, nismë kjo e dalë nga **“Akademia e Grave për Liderhip” program i NDI dhe USAID në Kosovë dhe e përkrahur prej FIQ avokon për mbledhjen dhe investimin e taksës për ambjent** në ambjent.

Në këtë kuadër, si pjesë e Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, KOSID, organizoi

konferencën “Kosova drejt Parisit COP21”, e cila mbledhi për diskutim autoritetet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet përgjegjëse që të krijojnë synime të qarta për angazhimin politik ndaj ndryshimeve klimatike, me qëllim pasqyrimin e problematikës dhe orientimet për nxitjen e institucioneve qeveritare në identifikimin e angazhimeve kombëtare në përgjigje të detyrimeve të Konferencës së Palëve (COP21) të Parisit.



**ICIJ, Huffington Post, Süddeutsche Zeitung, Bloomberg,
Paneli i Inspektimit të Bankës Botërore bashkëpunojnë me Forumin për
Iniciativa Qytetare për ndërkombëtarizimin e problemit të zhvendosjes
së banorëve të Hades dhe gjetjen e zgjidhjes.**



FIQ në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin në Obiliq ndërkombëtarizon problemin e Zhvendosjes së dhunshme të Banorëve të Hades dhe sjell në Kosovë **Panelin e Inspektimit të Bankës Botërore.**





FIQ, NDI dhe EKOSOVA avokojnë për mbledhjen dhe investimin e taksës së mjedisit në mjedis



Forumi për Filantropinë

Forumi për Iniciativa Qytetare – FIQ, publikoi raportin analitik lidhur me legjislacionin mbi filantropinë dhe OJQ-të. Ky forum u organizua në kuadër të Muajit të Filantropisë dhe për qëllim kishte diskutimin publik me akterët relevant rreth legjislacionit tatimor dhe kornizës tjetër ligjore në fuqi që prekë sektorin

e organizatave joqeveritare. Analiza e cila u publikua në këtë forum, ka për fokus çështjet e financimit të OJQ-ve, e në veçanti se sa është i favorshëm legjislacioni aktual i Kosovës që ka të bëjë me filantropinë si dhe sa u mundëson ky legjislacion Organizatave Joqeveritare një financim të qëndrueshëm.



Koktej “Filatropia për mentorim të ndërmarrësve të rinjë” – 20.11.2015

Kokteji “Filatropia për mentorim të ndërmarrësve të rinjë”, mbledhi në një vend bizneset e ndryshme dhe ndërmarrësit e rinjë që FIQ ka përkrahur deri tani në kuader të projektit ATAR si dhe me gazetarë nga mediumet e ndryshme të Kosovës.

Kokteji u organizua me qëllim të incimit të një diskutimi mbi filantropinë dhe mbi të gjitha për t'i falenderuar të gjithë partnerët tanë, që për 15 vite kanë qenë përkrah nesh, duke kontribuar në rritjen e FIQ-it dhe duke i dhënë kuptim punës tonë me komunitetin në të gjithë Kosovën.



Ceremonia e ndarjes së Çmimit FIDES për Filantropi në Kosovë

FIDES është një ngjarje tradicionale e cila promovon filantropinë, njeh dhe dekoron kontributin e filantropëve kosovarë për vitin aktual, dhe hap dyert për më shumë mundësi filantropike.

I gjithë Muaji i Filantropisë, kulmoi me Ceremoninë madhështore të FIDES 2015, për të shtatin vit me radhë.

FIQ për të shtatin vit me radhë organizoi ceremoninë e ndarjes së Çmimit FIDES 2015 edhe festoj 15 VJETORIN e themelimit të saj në prani të personaliteteve më të larta shtetërore e akademike.



Kategoritë dhe fituesit e çmimit FIDES 2015:

Çmimin FIDES për kontribut në nivel kombëtar (për kompanitë) – e fitoi **Fondacioni “Golden Eagle”** i cili gjatë vitit 2015 ka zhvilluar një numër të aktiviteteve humanitare, si mbështetje financiare për Shoqatën e fëmijëve me Autizem-Therande, shkollën për fëmijë me nevoja të veçanta Lef Nosi –Prizren, pastaj dhurimin e pajisjeve mjekësore për Klinikën e Pediatriisë në QKUK-së me vlerë prej 30,000 euro, pastaj ndarjen e 100 bursave për student me vlerë prej 90,000 eurove.



Këtë çmim në emër të FIQ e ndau përfaqësuesi i familjes Jashari Murat Jashari.

Çmimin FIDES për kontribut nga NVM-të (Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme) – **Korporata Rugove** u shpërblye për kontributin e dhënë përmes fushatës “1 Like 10 cent”. Qëllimi i kësaj fushate ishte sigurimi i fondeve për shoqatën e Down Syndrome Kosova si dhe vetëdijesimi i qytetarëve për sindromën Down.

Këtë çmim në emër të FIQ-it e ndau Dr. Ferid Agani, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimin FIDES për kontributin individual – ju dha Fresk

Sylhasi 11-vjeçar nga Prishtina i cili ka udhëtuar me biçikletë nga kryeqyteti i Kosovës deri në Sarandë, me një qëllim të mirë: të mbledhë fonde për nxënësit e shkollës së Thethit, në Shqipëri. Këtë çmim e ndau Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e FIQ-it.

Çmimi FIDES për kontribut nga diaspora (biznese, individë, OSHC nga diaspora) – e fitoi **Shpresa Xhakli** për ndihmën që u jep fëmijve me autizëm. Kështu – shqiptaro amerikanja Shpresa Xhaklli, filloi me “United for Autizm”, fondacioni në Kosovë, i cili ishte i pari dhe i vetmi i këtij lloji në vend dhe e parë që adreson nevojat e tyre dhe ndihmon për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë kosovare me autizmin. Këtë çmim në emër të FIQ-it e ndau Sadie Agani, gruaja e veprimtarit të ndjerë z. Fehmi Agani.

Çmimin FIDES për Inovacion (biznese, individë, OSHC) – e fitoi kompania **formon**. Krijim inovativ i printerit 3D, ku në vend të plastikës klasike të rrezikshme dhe të dëmshme për ambientin, përdorë si lëndë të parë plastikën biodegraduese e fituar nga përzierja e niseshtes së grurit dhe patates.



Këtë çmim në emër të FIQ-it e ndau rektori i Universitetit të Prishtinës, Prof.dr Ramadan Zejnullahu.

Çmimin FIDES për Fushatën më të mire vetëdijësuese (biznese, individë, OSHC) – E fitoi instalacioni i kreatores Alketa Xhafa Mripa **“Mendoj per Ty”** në përkrahje të viktimave të dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë.

Këtë çmim në emër të FIQ-it e ndau Veprorë Shehu e cila udhëheq organizatën jo-qeveritare “Medica Kosova”.

Një Çmim Special, ai për **Integritet Profesional** iu dha këtë natë znj. Mariah Thuraja Bamieh, e cila u shpreh shumë e kënaqur të vlerësohet në këtë formë në një kohë kur po tentohet të hetohet nga Prokuroria. Ajo poashtu u shpreh e gatshme të hetohet pa iu hequr imuniteti.

Ky Çmim u nda nga Drejtori i Rockefeller Brothers Fund për Ballkanin Perendimor, z. Haki Abazi.

Cermonia e Çmimit FIDES për Filantropi u mbështet nga Fondi Rockefeller Brothers.




FIQ gjithmonë afër organizatave lokale

FIQ, gjatë 2015-tës, **nënshkroi kontratat me organizatat që ka përzgjedhur në kuadër të projektit SIGN për Qëndrueshmëri**. Kontratat e nënshkruara pasqyrojnë grantin teknik për **5 organizata në vlera nga 1000€** për organizatë, grant ky që OJQ-të do ta shfrytëzojnë për ngritjen e fondeve. Ngritja e fondeve nga burime të ndryshme do të ketë mbështetjen në raport 1:1 nga FIQ, pra OJQ-të që arrijnë të ngrisin fondet e veta deri në 4000€, do të mbështeten edhe me 4000€ tjera nga FIQ. Kjo do të bëhet pas realizimit të Akademisë Rajonale për Qëndrueshmëri, që u mbajt në

Zlatibor, ku OJQ-të mësuan në mënyrë të detajuar nga ekspertë, se si të ngritin fondet kryesisht nga burimet lokale dhe do të gjen zbatim tashmë me përkrahjen dhe mentorimin e FIQ-it.

Qëllimi i këtij projekti është rritja e kapaciteteve të OJQ-ve në ngritjen e fondeve bazuar në donatorë të ndryshëm, kryesisht lokalë. SIGN për Qëndrueshmëri është një nismë rajonale, që financohet nga Komisioni European.

Grafikone që tregojnë Grantet që FIQ ka dhënë për 6 vite dhe fituesit e Çmimit FIDES, që nga viti 2009



FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
NË NIVEL
KOMBËTAR**

DATA PROJECT ELECTRONICS

per perkrahje te aktiviteteve me rendesi shoqerore,
aktivitete qe reflektojne perceptime pozitive si dhe
deshmojne solidaritet.

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
NË NIVEL
LOKAL**

SHARRCEM

kontribim ne
permiresimin e jetes
ne komunën e hanit te
elezit dhe kacanikut
duke mbeshtetur
aktivitete kulturore,
artin, edukimin,
infrastrukturen dhe
rinine.

FIDES çmimi për
**KONTRIBUTIN
E MEDIEVE**

per
emisionin
"Edhe une
jam Kosove",
emision qe trajton jeten e
skamnoreve ne Kosove duke
dhene nje shtyqe te fuqishme
drejt interesimit

RTV 21



**FIDES
2009**

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
KOMBËTAR**

**MERIDIAN
COPORATION
LLC**

kompani kjo e cila ka perkrahur
aktivitete me rendesi shoqerore,
aktivitete qe reflektojne perceptime
pozitive si dhe deshmojne solidaritet.



**FIDES
2010**

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
LOKAL**

kompani kjo e
cila ka
kontribuar në
përmirësimin
e jetesës në
komunën e
Deçanit duke
përkrahur
aktivitete kulturore,
infrastrukturën dhe rininë,

**KULLA
EXIM
SHPK**

person ky i cili
themeloi dhe punon
vullnetarisht në
shoqatën
humanitare
"Feniks" në Ferizaj,
përmes së cilës
gjatë pesë viteve
ndërtoi 70 shtëpi
për të pastrehët,
ndërsa vetëm gjatë
vitit 2010 ndërtoi 13
shtëpi.

FIDES çmimi për
**FILANTROPI
'ANTON ÇETA'**

**MILAIM
JASHARI
FENIKS**

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
KOMBËTAR**

REIFFEISEN BANK

PROCREDIT BANK

IPKO

për kontributin në përhapjen e teknologjisë informative.

FIDES çmimi për
**KONTRIBUTIN
LOKAL**

ELEKTROSTUBLLA

për kontributin në mbështetjen e organizimit të komunitetit në përmirësimin e infrastrukturës.

Melinda Rrahimi nga Danimarka për kontributin në mbështetjen e kategorive sociale dhe shkollave në disa komuna dhe znj. Ylfete Fanaj nga Zvicra për kontributin në integrimin shoqëror të bashkëkombasve tanë dhe të huajve në Zvicër.

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
INDIVIDUAL
NGA
DIASPORA**

MELINDA RRAHIMI

YLFETE FANAJ



**FIDES
2011**

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
LOKAL**

ABI PRIZREN

për përkrahje të aktiviteteve sportive dhe kulturore, përkrahje për shkollimin e fëmijëve bonjak, ndihma për familjet e varfëra, çmim ky i cili u dha nga Përfaqësuesi Special i Unionit European / Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Samuel Zbogar.



**FIDES
2012**

FIDES çmimi për
FILANTROPI

AUK CHARITY CLUB

për përkrahjen e grupeve të marginalizuara, si Down Syndrome Kosova, Fëmijët me aftësi të kufizuara, Kampanja mbi Kancerin e Gjirit, Kampanja mbi Alfabetin Braj dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre.

FIDES çmimi për
KONTRIBUT INDIVIDUAL

për punë vullnetare si neonatologe. Ky çmim u nda nga Ambasadori Norvegjez, z. Jan Braathu.

**DR.
MYNAVERE
HOXHA,**

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
NGA
DIASPORA**

për ndërtimin e bibliotekave të vogla për fëmijë në zonat rurale.

**BUNATEKA,
BNARCHITECTS
& ASSOCIATES,**

FIDES çmimi për
**KONTRIBUT
NË MJEDIS**

KOSOVA CAP PROJECT

për reciklimin e kapakëve të plastikës si burim për të blerë dhe dhuruar karroca për personat me aftësi të kufizuara. Çmimi u nda nga z. James Magbeth Forbes, Drejtor i zyrës së GIZ, për Kosovë dhe Maqedoni.

FIDES çmimi për FILANTROPI

IPKO TELECOMMUNICATIONS

për shkak të nivelit të lartë të Përgjegjësisë Sociale të Korporatës, të cilin e ndau Ambasadorja e ShBA-ve në Kosovë, znj. Tracey Ann Jacobson.

FIDES çmimi për KONTRIBUT LOKAL

nga Ferizaj, organizatë kjo e cila vetëm gjatë vitit 2013, ka arritur të ndërtoj 14 shtëpi për shtetëzët. Ky çmim u nda nga z. Michael Mora, zv/Drejtor regional i GIZ-it për Kosovë.

FENIKS

FIDES çmimi për KONTRIBUT INDIVIDUAL

për donacionin 500.000.00 Euro për ndërtimin e shkollës së re fillore në Gjakovë, me kapacitet për 550 nxënës, çmim ky që u nda nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë, z. Islam Lauka.

**KËLMEND
RIZVANOLLI**

FIDES çmimi për KONTRIBUT NGA DIASPORA

për promovimin e arsimit, kulturës dhe shkencës tek të rinjtë Kosovës, përmes bursave për student të dalluar. Këtë çmim e ndau z. Kim Mehmeti, publicist.

**FONDACIONI
SALIH E
ISA NUSHI**



**FIDES
2013**

FIDES çmimi për FILANTROPËT E RINJË

**SHKOLLA FILLORE
"NAIM FRASHËRI"**

për mbledhjen e fondeve për regullimin e kopshtit të shkollës, u nda nga z. Korab Ahmeti, menaxher i projektit Kosova Gap Project, i cili ishte fitues i FIDES 2012 për kontribut në mjedis.



**FIDES
2014**

FIDES çmimi për KONTRIBUT KOMBËTAR

IPKO FOUNDATION

për kontribut në arsim dhe teknologji informative.

FIDES çmimi për PARTNERITET FILANTROPIK

RUFKI SUMA

cili shquhet për ndërmarrjen e aktiviteteve filantropike dhe përkrahjen e grupeve të ndryshme sociale.

FIDES çmimi për KONTRIBUT INDIVIDUAL

që ndërtoi qendrën rinore në fshatin Gramnik të Klinës dhe përkrahjen e aktiviteteve tjera rinore.

**MISIN
ZENUNAJ**

**THE IDEAS
PARTNERSHIP**

FIDES çmimi për ORGANIZATA TE SHOQERISE CIVILE

për përkrahjen e grupeve të marginalizuara siç është komuniteti RAE, duke krijuar vende pune për gratë e këtij komuniteti dhe përfshirjen e fëmijëve në shkollë.

FIDES çmimi për KONTRIBUT NGA DIASPORA

**LAZIM
DESTANI**

i cili ka ndarë një pjesë të fitimeve të bizneseve të tij për qëllime bamirësie, mbështetje të projekteve kulturore dhe të arsimit, si dhe atyre të ambientit.

Të tjerët për FIQ!

Havushe Bajrami Bunjaku,
Themeluese e Biznesit Social '99 lule'

*“Bashkëpunimin me FIQ e kam filluar ne vitin 2014. Grantin e parë e kam shfrytëzuar për krijimin e plantacionit me bime mjekuese dhe aromatike. Gjate garës për Ide Biznesi te Gjelbëra dhe Inovative kam fituar garën dhe me paratë e grantit kam ndërtuar depon, të cilën e shfrytëzoj për ruajtjen e produkteve. Gjate këtij bashkëpunimi me FIQ, biznesi im është zhvilluar edhe në fushën e prodhimit dhe në fushën e ngritjes së cilësisë së produktit. Në biznesin tim janë të kyqura **20 gra të cilat u takojnë rasteve sociale.** Me këtë rast, unë falenderoj përzemërsisht FIQ-in që më ka fuqizua si gru në biznes dhe e ka ngrite dhe e ka zhvillu biznesin duke ndiku drejtpërdrejtë në ndihmen edhe të grave të komunitetit tim”*

Egzon Grajqevci,
Përfaqësues i Iniciativës për Ambient dhe Zhvillim Lokal IAZHL – Obiliq

“Bashkëpunimi jonë me FIQ-in ka fillu që në shkurt të vitit 2013, kur ne si një grup i aktivisteve të Komunës së Obiliqit kemi pasë përkrahje nga FIQ-i në realizimin e disa aktiviteve. Nga ky bashkëpunim me pas ka rrjedhë edhe deri te krijimi i OJQ-se IAZHL në Obiliq në qershor të 2013'tes. Që nga atehere kemi pasë mbështetje nga FIQ-i me grante teknike qe na ka mundësu operimin me punët brenda zyres.

Përvec aspektit financiar FIQ-i poashtu na ka ndihmu edhe në aspektin teknik, me trajnime të ndryshme për kualifikim të stafit, pastaj na ka perkrahë në krijimin e rrjetit te bashkëpunimit me organizatat tjera. Aktualisht me FIQ-in jemi duke



**Arta Ponosheci,
Organizata The Ideas Partnership**

punu edhe ne projektin e fshatit Hade, zhvendosjen e tij, nje proces qe ende është duke ndodhur. Falenderoj stafin e FIQ-it si për ndihmën e tyre me grante, qe na kanë mundesu operimin, poashtu edhe kohën e tyre në aspektin teknik qe na kanë dhënë. Gjithashtu kam një mesazh që të vazhdojë përkrahja ndaj organizatave tjera sepse kjo është forma e vetme, mendoj, për të kriju një qytetari aktive.”

“Bashkepunimi me FIQ-in ka fillu qysh në vitin 2013 ku kemi marre pjesë në garën rajonale për ide të gjelbërta, ku e kemi përfaqësu Kosovën në rajon.

Aty kemi fitu edhe çmimin prej 10.000 dollarësh nga RBF. Përpos këtij fondi dhe vazhdimësisë që kemi pasë me FIQ-in, kemi marre pjesë në trajnime për zhvillim dhe qëndrueshmëri, dhe kështu kemi marre edhe Çmimin FIDES në 2014. Jemi shumë falenderues për bashkëpunimin që kemi pasë deri tash me FIQ-in dhe shfrytëzoj rastin që në emër të The Ideas Partnership t’ia uroj FIQ-it 15 vjetorin e themelimit.”

Bashkëpunimet dhe partneritetet kyçe me rrjetet lokale dhe regjionale

FIQ, ka një bashkëpunim të ngushtë me rrjete si lokale, po ashtu edhe regjionale, ku ndër to vlen të cekën **Konsorciumi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID)**, në të cilin FIQ luan rolin e organizatës komunitare, dhe kjo sigurisht na bën të ndihemi shumë krenar, meqë puna jonë në KOSID pasqyron kërkesat dhe nevojat e komuniteteve në vend.

Poashtu **FIQ është pjesë e rrjetit SIGN për Qëndrueshmëri, rrjet ky i cili përbëhet nga organizatat e të gjitha shteteve të Ballkanit Perendimor, duke synuar kështu**

mbështetjen e qytetarëve për iniciativat e shoqërisë civile dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillim e filantropisë.

Së fundi, FIQ është bërë pjesë poashtu edhe e një rrjeti tjetër, është ky **Balkan Green Foundation (BGF)**, e cila njihet si një initiative rajonale, që është krijuar për të avokuar dhe promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në Ballkanin Perendimor.



Aktivitetet në kuadër të SIGN Network!



Aktivitete në kuadër të KOSID

FIQ në media 2015

Dajana Berisha, flet mbi të vërtetën e zhvendosjes së detyruar në Kosovë – RTK



RTK – Peticioni kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike – FIQ në kuadër të KOSID, në 2014'tën arriti të mbledhë jo më pak se 33.000 nënshkrime të qytetarëve në gjithë Kosovën!



RTK – Dajana Berisha dhe Egzon Grajqevci flasin mbi fushatën e realizuar nga e gjithë Kosova për Obiliqin! “Dhuro pemën tënde, Jepi jetë një komuniteti” - FIQ gjithmonë pranë komuniteteve në nevojë!



Platforma kallxo.com, përcjellë gjithë ngjarjen me rastin e mbjelljes së luleve dhe pemëve në Shkabaj – Hade e Re, Obiliq!



Tribuna Channel, Zhgënjimi mbi mosvotimin e peticionit të mbi 33.000 qytetarëve kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike! Dajana Berisha dhe Visar Azemi – në Konferencën për media!





RTK – Dajana Berisha – Drejtore Ekzekutive e FIQ, flet mbi Muajin e Filantropise 2015 si dhe 15 vjetorin e punës së FIQ-it me komunitetin! Sukseset 15 vjeçare të FIQ-it na bëjnë krenarë!



Kushtrim Puka në Klan Kosova, flet mbi shkeljen e Ligjit në rastin e Kosovës së Re



KosovaPress – Të rinjtë përfitojnë nga 2.500 euro në bujqesi dhe ekoturizëm! Projekti ATAR



Ceremonia e ndarjes së çmimeve FIDES 2015, e transmetuar në RadioTelevisionin 21 – Në foto Fresk Sylhasi, Filantropi më I ri në Kosovë!



Debat Jeta në Kosovë, Shoqëria Civile dhe Politika, Dajana Berisha prej FIQ!
Debatin e plotë mund ta ndiqni në kallxo.com.

Stafi 2015

Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive

Kushtrim Puka, Menaxher i Programeve

Sefë Govori, Menaxher i Financave

Arieta Dragusha, Zyrtare e Programit

Lule Bahtiri, Zyrtare e Programit

Ardiana Zenuni, Zyrtare për Komunikim

Meivis Struga, Zyrtar i Projektit

Arlinda Azemi, Praktikante

Falenderime të veçanta:





Lagja Pejton, Rr.Sejdi Kryeziu,
Blloku 20, nr. 3, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 248 677
www.fiq-fci.org